PROJEKTI : "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS- Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren"

# PËRFSHIRJA E KOMUNITETIT NË PROCESIN E VIZIONIMIT TË HAPËSIRËS NË LAGJEN ORTAKOLL



Punuan:
Edon Mullafetahu kand. arkitekt
Nora Temaj kand. arkitekt
tetor,2015

PËRMBAJTJA


**HYRJA** .......... **1**

**1. TAKIMI I PARË ME QYTETARË** .......... **3**

1.1 Brainstorming-u (stuhi mendimesh) .......... 3

1.2 Listimi i kërkesave të qytetarëve .......... 3

**2. PROCESI I PUNËS DERI TE PROPOZIMI** .......... **4**

2.1 Observimi dhe analiza .......... 4

2.2. Reflektimi dhe Propozimi .......... 5

**3. TAKIMI I DYTË ME QYTETARË** .......... **7**

3.1. Prezentimi i propozimit dhe diskutimi .......... 7

**SHTOJCA** (Parallogaria ) .......... **9**

## HYRJA

*'Kurrë mos dysho se një grup i vogël i qytetarëve të kujdesshëm, të zotuar mund ta ndryshojnë këtë botë; vërtetë kjo është e vetmja gjë që gjithmonë munden'- MARGARET MEAD*[1]

Përfshirja e komunitetit në rregullimin e hapësirave publike është njëra prej metodave më të përdorura për të arritur deri te dizajni, sepse janë qytetarët ata të cilët i përdorin ato hapësira dhe ballafaqohen me probleme të cilat planeri apo urbanisti mund vetëm t'i parashikojë, por jo të jetë dëshmitar i tyre.

Si qëllim kryesor në planifikim të hapësirës publike është krijimi i sinergjisë në mes të elementeve në hapësirë dhe ndërmjet njerëzve që e shfrytëzojnë hapësirën.

Në rastin tonë është marrë për shqyrtim një hapësirë publike në lagjen Ortakoll. Kjo hapësirë i takon banorëve të bllokut, por edhe të gjithë qytetarëve të cilët kalojnë andej. Trajtimi i kësaj hapësire fillon me qytetarët që më së shumti e përdorin atë( banor dhe është hapësira e vetme e hapur e tyre.

Secila kërkesë e tyre do të merret parasysh, kuptohet që vetëm për hapësirën rreth bllokut, dhe do të shqyrohet më tej për ta krijuar ***një vend*** jo thjesht një dizajn.

[1] *How to turn a place around*, PPS (Project for Public Spaces), Katheleen Madden, New York, 2005

`




EMA
BARNATORE
Ladies center









`

# 1. TAKIMI I PARË ME QYTETARË

## 1.1 Brainstorming (Stuhi mendimesh)

Në këtë fazë kanë qenë të pranishëm vetëm njëmëdhjetë(11) qytetarë nga i gjithë blloku i cili numron 32 banesa(rreth 150 banorë). Pjesa më e madhe kanë qenë meshkuj.

Debatin e kemi filluar me pyetjet si: Cilat janë kërkesat tuaja për hapësirën që e shfrytëzoni çdo ditë?, Çka i mungon kësaj hapësire? Çka paraqet problem për ju në këtë hapësirë? Si qëndron puna me qasjen, aktivitetet, komoditetin dhe afërsinë sociale?

Meqë si metodologji preferuam debatin e thjeshtë (stuhi mendimesh), qytetarët u ndinë të lirë për t'i shprehur shqetësimet dhe kërkesat e tyre. Ata potencuan edhe probleme të tjera për konstruksionin e ndërtesës, të cilat probleme do t'i adresohen Komunës së Prizrenit.



`

## 1.2 Listimi i kërkesave të qytetarve

Për banorët problem ishin:

- Mungesa e hijes
- Pluhuri
- Zhurma (nga automjetet dhe fëmijët)

Ndërsa kërkesat e tyre ishin:

- Më shumë gjelbrim (të ulët dhe të lartë)
- Ulëse
- Ujë (fontanë)
- Zgjerim i hyrjes kryesore
- Ndriçim publik
- Furnizimi me ujë vetëm për ujitje



DRYSHE

## 2. PROCESI I PUNËS DERI TE PROPOZIMI

### 2.1 Observimi dhe analiza (Diagramet e gjendjes ekzistuese)

ORIENTIMI




ZHURMA




Orientimi, ndriçimi, zhurma si dhe ngjarjet te tjera në lokacion janë faktorët që ndikojnë në locimin e aktiviteteve ( propozimin) brenda hapësirës publike.

NDRIÇIMI



PROBLEMET/NGJARJET NË LOKACION



## 2.2 Reflektimi dhe propozimi (Diagramet e konceptit)




Shtigjet të cilat formohen vetë nga qytetarët jane treguesit më të mirë se ku, si dhe çfarë forme duhet të kenë ato. Dizajni urban i shfrytëzon shtigjet e trasuara si fazë fillestare e locimit të aktiviteteve brenda një hapësire publike.

Edhe në rastin tonë, kanë qenë këto shtigje të cilat ia kanë dhënë formën përfundimtare kësaj hapësire.

FUNKSIONET




Funksionet brenda kësaj hapësire publike janë përcaktuar në bazë të ngjarjeve që ndodhin vazhdimisht në lokacion. Kjo ndarje e përgjithshme është bërë sa për orientim fillestar për të vazhduar më tej më një ndarje më të detajuar.

Pas ndarjes së përgjithshme të funksioneve kemi skemën e propozimit nga e cila prodhohet dizajni për këtë hapësirë deri në detaje.

ECMA NDRYSHE

SKEMA E PROPOZIMEVE,
MOBILIARI URBAN



`

## 3. TAKIMI I DYTË ME QYTETARË

### *3.1. Prezentimi i propozimit dhe diskutimi*

Master plani për hapësirën publike në lagjen 'Ortakoll'





Pas prezentimit të propozimit, qytetarët ishin të pajtimit me propozimin.

**Parallogaria e realizimit te parkut ne lagjen Ortakoll**

**Lokacioni: PRIZREN**

| | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Totali ne Euro |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **PUNET PERGATITORE** | | | | |
| 1.1 | Pergatitja e terenit | LS | 1 | 50.00 | 50.00 |
| 1.2 | Largimi i rrethojes ekzistuese metalike | LS | 1 | 150.00 | 150.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE PERGATITORE** | | | | **200.00** |
| | | | | | |
| **2** | **PUNET E DHEUT** | | | | |
| 2.1 | Eskavimi i dheut siperfaqesor pergjate shtigjeve te ecjes me gjeresi 80cm dhe thellesi 20cm si dhe ne hapesirat rekreative | $m^3$ | 86 | 3.50 | 302.09 |
| 2.2 | Shtrimi dhe kompaktesimi i zhavorit me fraksion 0-60mm për përgaditjen e siperfaqeve pergjate shtigjeve te ecjes dhe ne hapesirat rekreative. Kompaktesimi i dheut dhe zhavorit duhet te behet deri ne $30N/mm^2$. | $m^3$ | 43 | 10.00 | 431.55 |
| 2.3 | Shpimi i bunarit per ujitje | m' | 10 | 45.00 | 450.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE DHEUT** | | | | **1,183.64** |
| | | | | | |
| **3** | **PUNET E BETONIT** | | | | |
| 3.1 | Shtrimi i shtreses se betonit te armuar me rrjete Ø8/15 cm per përgaditjen e siperfaqeve pergjate shtigjeve te ecjes, ne hapesirat rekreative. Trashësia e shtresës 10 cm. | $m^3$ | 31 | 70.00 | 2,175.60 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE BETONIT** | | | | **2,175.60** |
| | | | | | |
| **4** | **PUNET E DYSHEMESE** | | | | |
| 4.1 | Shtrimi i pllakave 60x 60cm pergjate shtigjeve te ecjes | m2 | 215 | 19.00 | 4,085.00 |
| 4.2 | Punimi i dyshemese akrilike me te gjitha shtresat ne hapesiren per femije, hapesiren per pushim, dhe hapesiren e parkingut te bicikletave. | m2 | 122 | 35.00 | 4,264.05 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE DYSHEMESE** | | | | **8,349.05** |

| | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Totali ne Euro |
|---|---|---|---|---|---|
| **5** | **PUNET E GJELBERIMIT** | | | | |
| 5.1 | Pergatitja e siperfaqes dhe rregullimi i hapesirave gjelberuese me te gjitha operacionet e nevojshme të shtruarjes së dheut, rrafshimit, ngjeshjes, plehërosjes dhe hudhjes së farës se barit. | m2 | 751 | 2.00 | 1,502.00 |
| 5.2 | Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve | cope | 18 | 30.00 | 540.00 |
| 5.3 | Punimi i gardhit te gjelber | m' | 177 | 1.50 | 266.03 |
| 5.4 | Furnizimi dhe mbjellja e gjelberimit dekorativ | LS | 1 | 600.00 | 600.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE GJELBERIMIT** | | | | **2,908.03** |
| **6** | **PUNET E INST. ELEKTRIKE DHE TE UJIT** | | | | |
| 6.1 | Punimi i instalimeve elektrike | LS | 1 | 600.00 | 600.00 |
| 6.2 | Punimi i instalimeve te ujit perfshire pompen dhe te gjitha instalimet tjera te nevojshme per ujitje dhe furnizim te fontanes | LS | 1 | 500.00 | 500.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE INST. ELEKTRIKE DHE TE UJIT** | | | | **1,100.00** |
| **7** | **MOBILERIA URBANE** | | | | |
| 7.1 | Punimi i uleseve nga betoni, perfshire te gjitha operacionet percjellese si krijimin e prototipit, kallupimin dhe prodhimin | cope | 12 | 470.00 | 5,640.00 |
| 7.2 | Punimi i tavolinave nga betoni, perfshire te gjitha operacionet percjellese si krijimin e prototipit, kallupimin dhe prodhimin | cope | 6 | 290.00 | 1,740.00 |
| 7.3 | Furnizimi me montimi i shportave e mbeturinave | cope | 8 | 65.00 | 520.00 |
| 7.4 | Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçues | cope | 12 | 190.00 | 2,280.00 |
| 7.5 | Furnizimi dhe montimi i parkingjeve te bicikletave | m2 | 2 | 180.00 | 360.00 |
| 7.6 | Furnizimi me montimi i pengesave rrugore ne pjesen e hyrjes | m2 | 5 | 20.00 | 100.00 |
| 7.7 | Furnizimi dhe montimi i fontanes | LS | 1 | 800.00 | 800.00 |
| | **TOTALI I MOBILERISE URBANE** | | | | **11,440.00** |

| | | | | TOTALI NE EURO |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **PUNET PERGATITORE** | | | 200.00 |
| **2** | **PUNET E DHEUT** | | | 1,183.64 |
| **3** | **PUNET E BETONIT** | | | 2,175.60 |
| **4** | **PUNET E DYSHEMESE** | | | 8,349.05 |
| **5** | **PUNET E GJELBERIMIT** | | | 2,908.03 |
| **6** | **PUNET E INST. ELEKTRIKE DHE TE UJIT** | | | 1,100.00 |
| **7** | **MOBILERIA URBANE** | | | 11,440.00 |
| | | | | **27,356.31** |

**Parallogaria e realizimit te parkut ne lagjen Ortakoll**

**Lokacioni: PRIZREN**

| | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Totali ne Euro |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **PUNET PERGATITORE** | | | | |
| 1.1 | Pergatitja e terenit | LS | 1 | 50.00 | 50.00 |
| 1.2 | Largimi i rrethojes ekzistuese metalike | LS | 1 | 150.00 | 150.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE PERGATITORE** | | | | **200.00** |
| | | | | | |
| **2** | **PUNET E DHEUT** | | | | |
| 2.1 | Eskavimi i dheut siperfaqesor pergjate shtigjeve te ecjes me gjeresi 80cm dhe thellesi 20cm si dhe ne hapesirat rekreative | $m^3$ | 86 | 3.50 | 302.09 |
| 2.2 | Shtrimi dhe kompaktesimi i zhavorit me fraksion 0-60mm për përgaditjen e siperfaqeve pergjate shtigjeve te ecjes dhe ne hapesirat rekreative. Kompaktesimi i dheut dhe zhavorit duhet te behet deri ne $30N/mm^2$. | $m^3$ | 43 | 14.00 | 604.17 |
| 2.3 | Shpimi i bunarit per ujitje | m' | 10 | 45.00 | 450.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE DHEUT** | | | | **1,356.26** |
| | | | | | |
| **3** | **PUNET E DYSHEMESE** | | | | |
| 3.1 | Furnizimi dhe montimi I kubëzave nga betoni me dim. t= 8 cm - MB 30 mbi rërë me t=5 cm dhe vendosja e naillonit nën rërë . | m2 | 215 | 10.00 | 2,153.11 |
| 3.2 | Furnizimi dhe montimi i skajoreve, me baze betoni | m' | 578 | 8.50 | 4,911.64 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE DYSHEMESE** | | | | **7,064.75** |

| | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Totali ne Euro |
|---|---|---|---|---|---|
| **4** | **PUNET E GJELBERIMIT** | | | | |
| 4.1 | Pergatitja e siperfaqes dhe rregullimi i hapesirave gjelberuese me te gjitha operacionet e nevojshme të shtruarjes së dheut, rrafshimit, ngjeshjes, plehërosjes dhe hudhjes së farës se barit. | m2 | 751 | 1.50 | 1,126.50 |
| 4.2 | Furnizimi dhe mbjellja e drunjeve | cope | 18 | 25.00 | 450.00 |
| 4.3 | Punimi i gardhit te gjelber | m' | 177 | 1.50 | 266.03 |
| 4.4 | Furnizimi dhe mbjellja e gjelberimit dekorativ | LS | 1 | 600.00 | 600.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE GJELBERIMIT** | | | | **2,442.53** |
| **5** | **PUNET E INST. ELEKTRIKE DHE TE UJIT** | | | | |
| 5.1 | Punimi i instalimeve elektrike | LS | 1 | 600.00 | 600.00 |
| 5.2 | Punimi i instalimeve te ujit perfshire pompen dhe te gjitha instalimet tjera te nevojshme per ujitje dhe furnizim te fontanes | LS | 1 | 500.00 | 500.00 |
| | **TOTALI I PUNEVE TE INST. ELEKTRIKE DHE TE UJIT** | | | | **1,100.00** |
| **6** | **MOBILERIA URBANE** | | | | |
| 6.1 | Furnizimi dhe montimi i uleseve te gatshme nga metali dhe druri | cope | 8 | 240.00 | 1,920.00 |
| 6.2 | Furnizimi dhe montimi i tavolinave te gatshme nga metali dhe druri | cope | 4 | 150.00 | 600.00 |
| 6.3 | Furnizimi me montimi i shportave e mbeturinave | cope | 8 | 65.00 | 520.00 |
| 6.4 | Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçues | cope | 12 | 190.00 | 2,280.00 |
| 6.5 | Furnizimi dhe montimi i parkingjeve te bicikletave | m2 | 2 | 180.00 | 360.00 |
| 6.6 | Furnizimi me montimi i pengesave rrugore ne pjesen e hyrjes | m2 | 5 | 20.00 | 100.00 |
| 6.7 | Furnizimi dhe montimi i fontanes | LS | 1 | 800.00 | 800.00 |
| | **TOTALI I MOBILERISE URBANE** | | | | **6,580.00** |

| | | TOTALI NE EURO |
|---|---|---|
| **1** | **PUNET PERGATITORE** | 200.00 |
| **2** | **PUNET E DHEUT** | 1,356.26 |
| **3** | **PUNET E DYSHEMESE** | 7,064.75 |
| **4** | **PUNET E GJELBERIMIT** | 2,442.53 |
| **5** | **PUNET E INST. ELEKTRIKE DHE TE UJIT** | 1,100.00 |
| **6** | **MOBILERIA URBANE** | 6,580.00 |
| | | **18,743.53** |